



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01-Nr.60/01-1739/26
Kaçanik, 30.01.2026

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin të 17 Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB –03/2012 MAPL -Për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, nenit 6 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 60/01- 1739/26 prej datës 19.01.2026, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me 30 janar 2026, mori këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)

1. Me këtë Vendim, themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Komunën e Kaçanikut, në përbërje si vijon:
 - 1.1 Kryetari i Komunës, Sabedin Vishi- Kryesues,
 - 1.2 Komandanti i Stacionit Policor në Kaçanik, Emrush Lalinovci,
 - 1.3 Përfaqësuesi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Kaçanik, Fidaïm Fazliu,
 - 1.4 Kryesuesi i Komitetit për Komunitetet, Betim Shala,
 - 1.5 Zyrtari për Barazi Gjimore, Vedat Dema,
 - 1.6 Drejtori i Drejtorisë për Arsim, Gazmend Bunjaku,
 - 1.7 Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit, Emrin Dema,
 - 1.8 Përfaqësuesi i FSK-së,
 - 1.9 Përfaqësuesi i Këshillit Lokal për Siguri Publike, Shqiponje Vogliqi,
 - 1.10 Kryesuesi i Ekipit Veprues Komunal për Siguri në Bashkësi, Fatmir Çaka,
 - 1.11 Përfaqësuesi nga Sektori i Emergjencave Civile dhe Komunale, Arian Teneqja,
 - 1.12 Përfaqësuese e Komuniteteve, Deana Muhaxheri,
 - 1.13 Përfaqësuesi i OJQ-ve Lokale, Naim Hysa,
 - 1.14 Përfaqësuesi i Bizneseve, Ylber Tusha,
 - 1.15 Përfaqësuesi nga Komuniteti lokal i personave me aftësi të kufizuar, Elmihane Malsiu.
2. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është përgjegjës për veprimet dhe detyrat e përcaktuara sipas Udhëzimit Administrative Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL Për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Anëtarët e KKSBB-së.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës (përmes Zyrës së Kryetarit, njoftohen anëtarët e KKSBB), Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data 24.02.2026	Vendi Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë
	01-060/01-4838/26	

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL
Nga:	Erbilin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e kuvendit të komunës në vijim:

Vendim 01 Nr. 60/01-1739/26 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)
I miratuar më datë: 30.01.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.02.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2026, ka miratuar Vendimin 01 Nr. 60/01-1739/26 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, është bazuar në nenin 12.2 (d) lidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), në Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për këshillat komunale për siguri në bashkësi, dhe në nenin 6 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, me të cilin vendim është themeluar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me datë 30.01.2026, është miratuar më 13 vota për, 6 kundër dhe 0 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.